



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Kom.Dh.Shk.II.nr.995/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari individual Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit .T.SH. “Delfina”, me seli në Malishevë, kundër debitorit Komuna e Malishevës Drejtoria e Arsimit, me seli në Malishevë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, KPPP.nr.792/2022 i datës 25.05.2023, me datë 23.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit Komuna e Malishevës Drejtoria e Arsimit, me seli në Malishevë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, KPPP.nr.792/2022 i datës 25.05.2023, ashtu që vendoset si në vijim: APROVOHET prapësimi i debitorit Komuna e Malishevës, me seli në Malishevë, i ushtruar ndaj urdhrorit për përmbarim P.nr.642/2021 të datës 14.01.2021 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, si i bazuar, ndërsa propozimi për përmbarim i kreditorit REFUZOHET SII PA BAZUAR, ashtu që SHFUQIZOHET në tërësi urdhri për përmbarim P.nr.642/2021 i datës 14.01.2021 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë dhe abrogohen të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra në këtë çështje përmbarimore.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.792/22 të datës 25.05.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Malishevës, të paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.642/2021 të datës 14.10.2021, të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit është lënë në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.642/2021 i datës 14.10.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori Komuna e Malishevës, me seli në Malishevë, me propozimin që aktvendimi i atakuar dhe urdhri i Përmbaruesit Privat të anulohet dhe propozimi për përmbarim të refuzohet si i pa bazuar, pasi që debitori e ka përmbushur

detyrimin duke e ekzekutuar këtë pagesë me dt.6,680 Euro, gjë që vërtetohet nga urdhër pagesat e thesarit. Po ashtu edhe kreditori ka dërguar parashtrësë të përmbartuesi privat me të cilën e tërheq propozimin për përmbartim dhe ka paguar tashmë shpenzimet e procedurës së përmbartimit.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.642/2021 i datës 14.10.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Fatura Nr. FSM-20-000050 e datës 19.02.2021, duke obliguar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën prej 6,940.00 euro, me kamatë ligjore nga dita e lëshimit të faturës e deri në ditën e pagesës definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e konteston borxhin si dhe faturën e datës 19.02.2021, të ofruar nga kreditori me arsyetimin se kjo faturë nuk i plotëson kushtet për përmbartim sipas nenit 29 të LPP-së pasi që është në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik të Kosovës, pasi që nuk janë përcjellë procedurat e prokurimit publik të paguhet 10 % e vlerës së saj. Në bazë të kërkesës së menaxherit të kontratës nr. 37 të prokurimit publik-mbikëqyrësi i saj ka bërë kërkesë për ndryshim të pozicioneve të kësaj kontrate, kryetari i komunës e ka miratuar pjesërisht kërkesën e tij për ndryshim të kontratës dhe ka kërkuar të respektohet Ligji i Prokurimit Publik. Ka shtuar se mbikëqyrësi i kontratës ka bërë një pranim teknik të furnizimit me inventar pa u respektuar procedurat sipas aktvendimit të kryetarit të kontratës. Në fund i ka propozuar Gjykatës që të pranoj si të bazuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe të anuloj Urdhërin për Përmbartim P.nr.642/21 i datës 14.10.2021, të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi.

Duke vendosur sipas prapësimit Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.792/22 të datës 25.05.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Malishevës, të paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.642/2021 të datës 14.10.2021, të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit është lënë në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.642/2021 i datës 14.10.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht

Faturën nr. FSM–20-000050 të datës 19.02.2021, në shumën prej 6,940.00 euro, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shumta e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar pretendimet e debitorit se urdhri për përbarim nuk është i rregullt dhe nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në LPP-ë, sipas të cilit propozimi për përbarim duhet të ketë edhe nënshkrimin e faturës së pranuar, se nuk ka prova se fatura është dorëzuar tek debitori, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar përbarimi mbanë vulën e protokollit të debitorit ne numër 03/1224 të datës 17.05.2021, dhe nga vet fakti se personat të cilët e kanë vulosur faturën i është dhënë vula në posedim vërtetohet se të njëjtat kanë qenë të autorizuar për pranimin e faturave.

Gjykata Komerciale e Kosovës– Dhomat e shkallës së dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, nuk mund ta pranojë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, për faktin se kjo e fundit gabimisht ka konstatuar se fatura që është objekt përbarimi i plotëson kushtet ligjore dhe se e njëjta duhet të ekzekutohet. Kjo për faktin se pas analizimit dhe vlerësimit të ankesës dhe provave të dorëzuara me ankesë rezulton se debitori e ka ekzekutuar këtë pagesë me dt. 22.07.2022 në shumën prej 6,680 Euro duke ia bashkangjitur ankesës edhe urdhër pagesën për faturën e lëshuar nga Thesari. Po ashtu debitori, ankesës ia ka bashkangjitur edhe një parashtresë me të cilën e njofton përbaruesin privat se lidhur me urdhrin përbarimor P.nr.642/21 lidhur me faturat nr.03/1224 të dt. 17.05.2021 në vlerë prej 6,940 Euro. Andaj kreditori në parashtresën për tërheqje të urdhrin përbarimor deklaron se tërhiqet në vlerën e borxhit prej 6,940 euro.

Përkritazi me pretendimet e debitorit në ankesë, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret debitori e ka kryer detyrimin epr të cilin është ngarkuar me urdhrin për përbarim lidhur me faturën mbi të cilat është caktuar urdhri për lejimin e përbarimit.

Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se në rastin konkret meqë debitori e ka përmbushur detyrimin dhe kreditori është tërhequr nga kërkimi i kredisë sipas përbarimit, janë plotësuar kushtet ligjore, sipas të cilave vihet deri te përfundimi se urdhri për përbarim duhet ndryshuar dhe të aprovohet prapësimi.

Me nenin 71 pika të LPP-së është paraparë se sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.8. *“kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori me nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurës nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbylljes së një ujdje gjyqësore ose një ujdje administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër”*;

Në kuptim të arsyeve të theksuara, Gjykata vlerëson se fakti se debitori e ka përmbushur detyrimin e kërkuar me dokumentin e besueshëm, ndërkaq kreditori është tërhequr nga propozimi për përmbarim, Dhomat e shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, vlerësojnë ndryshe provat nga shkresat e lëndës dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit dhe të refuzohet propozimi për përmbarim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së.

Sa u përket shpenzimeve të procedurës, u vendos konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së duke vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta, pasi që e debitori nuk i kishte kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika c) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.995/23, me datë 23.10.2023,

Gjyqtari,
Dren Rogova,